

ENGJËLLUSHE KARAJ

**KLASIFIKIMI TIPOLOGJIK I FJALORIT TË GJUHËS SHQIPE
TË A. XHUVANIT**

Pranë Kartotekës së Leksikut të Gjuhës Shqipe, gjendet edhe fondi i prof. dr. Aleksandër Xhuvani. Bëhet fjalë për një fond me rreth 43 500 skeda, një pasuri e tërë, e mbledhur apo e vjelë prej profesorit. Në këtë studim/trajtesë do të ndalemi te kjo pasuri leksikore që ai mendonte ta botonte si një fjalor të gjuhës shqipe. Ai nuk arriti që ta hartonte si një vepër të përfunduar leksikografike. Prof. A. Xhuvani bëri vetëm fazën e regjistrimit. Materiali i skedave më pas u përzgjedh, u përpunua dhe u botua pjesë-pjesë në revistën “Studime filologjike” nga M. Domi dhe Q. Haxhihasani.

Ka shumë diskutime për natyrën apo tipin e Fjalorit të gjuhës shqipe¹ të Aleksandër Xhuvanit, diskutime që e kanë bazën te lënda leksikore, frazeologjike dhe semantike që përfshin (në botimin e bërë) ose që do të përfshinte në një botim të plotë. Duke u mbështetur në kriteret e hartimit të një vepre leksikografike, në përvojën botërore² dhe atë shqiptare³ për klasifikimin e fjalorëve sipas ndërtimit, sipas përmbajtjes së lëndës, sipas funksionit, sipas përdoruesit (kujt i drejtohet) dhe sipas formatit të qarkullimit (i shtypur apo elektronik) do të përpiqemi të përcaktojmë natyrën e vepres.

Sipas J. Thomait “*Fjalori* është vepër gjuhësore që përmban një numër të madh fjalësh, të renditura alfabetikisht, përkrah të cilave jepen shpjegimet për

¹ Këtë Fjalor ne jemi duke e përgatitur për ta botuar në një vepër më vete. Për këtë ne po bazohemi te fondi i Aleksandër Xhuvanit dhe, sigurisht edhe në materialin e botuar në revistën “Studime filologjike”.

² R. R. K. Hartman & G. James, *Dictionary of Lexicography*, New York, 2001; S. Tarp, *Lexicographica Seris Major: Lexicography in the borderland between knowledge and non-knowledge: general lexicographical theory with particular focus on learner's lexicography*, New York, 2008, P. Swanepoel, *Dictionary typologies: a pragmatic approach*, në “A practical guide to lexicography”, 2003; H. Yong & J. Peng, *Bilingual lexicography from a communicative perspective*, Amsterdam, 2007; Z.S.Hawel, *A study on the approaches of classifying dictionaries with and evaluation of dictionaries used by the students of translation*, në “Journal of the College of Arts University of Basrah”, 43, 2007; J. R. Debove, *Typologie des dictionnaires généraux monolingues de la langue actuelle*, Quaderni del CIRSIL – 4 (2005) – www.lingue.unibo.it/cirsil, etj.

³ J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006; J. Thomai, *Leksikografia shqipe – trashëgimi e perspektivë*, në Konferencën shkencore “Leksikografia shqipe – trashëgimi e perspektivë”; Rami Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, Tiranë 2005; V. Memisha, *Studime për fjalën shqipe*, Tiranë, 2011; E. Haska, *Rreth leksikografisë shqipe njëgjuhëshe të shekullit XXI*, tezë doktore, Tiranë, 2015.

kuptimet e tyre leksikore (në fjalorët shpjegues), si edhe trajtat plotësuese të fjalëve, shënimet e nevojshme gramatikore, stilistike a për fushën e përdorimit, thënie, shembuj etj. Për lëndën që përfshin një fjalor, sipas tipit, shfrytëzohen kartotekat e leksikut, si edhe burimet e gjuhës së shkruar e të folur. Ka shumë tipa fjalorësh, por me një ndarje të madhe ata grupohen në fjalorë enciklopedikë dhe në fjalorë filologjikë⁴. Fjalori i Xhuvanit kuptohet që është një vepër filologjike dhe jo enciklopedike.

Një vepër leksikografike gjykohet e vlerësohet nga një radhë faktorësh: një fjalor i mirë, shkencor, mbështetet mbi një teori, sipas së cilës përcaktohet tipi i fjalorit nga vëllimi, nga natyra e fjalëve që përfshin, nga parimet, kriteret e zgjidhjet leksikografike që zbatohen, nga shtresimi i fjalësit sipas burimit, sipas normës ose sipas formimit, nga mënyra e shkalla e zbërthimit kuptimor ose nga ndërtimi i strukturës kuptimore për çdo fjalë, nga zbulimi e pasqyrimi i vlerave kuptimore, shprehëse, emocionuese e stilistike të fjalëve dhe nga shumë anë të tjera.

Nëse do t'i referoheshim llojit të fjalorit sipas vëllimit lëndor dhe sipas numrit të lemave që përfshin fjalori i Aleksandër Xhuvanit është fjalor i tipit të vogël pasi ai ngërthen në makrostrukturën e tij rreth 15 000 fjalë⁵.

Nëse do të shohim lëndën që pasqyrojnë, fjalorët mund të jenë të përgjithshëm (të mbarë gjuhës), dialektorë a krahinorë, fjalorë fjalësh (leksemorë), frazeologjikë, sinonimikë, antonimikë, terminologjikë, onomastikë, të autorëve, shkollorë, të fushave të veçanta (gjuhësorë, poetikë, erotikë, mitologjikë, me emërtime kafshësh a bimësh...) etj., fjalori i prof. Aleksandër Xhuvanit lë mundësi interpretimi. Ai nuk mund të jetë një fjalor i përgjithshëm sepse "Fjalori i përgjithshëm i një gjuhe synon të përshkruajë leksikun e saj, por nuk mund të përshkruajë të gjithë fjalët. Fjalët që zgjidhen janë më të përdorshmet (frekuencë—/—shpërndarje); sa më shumë shtohet nomenklatura, aq më të rralla bëhen fjalët."⁶

Megjithatë, nga një krahasim që i kemi bërë lëndës së Fjalorit të Xhuvanit të botuar në SF, me Fjalorin e Gjuhës së Sotme Shqipe (1980) rezulton se një pjesë e madhe e fjalëve të veprës së profesorit kanë zë vend në veprën akademike. Kurse një numër i konsiderueshëm i tyre nuk gjenden aty, që në

⁴ J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f. 305.

⁵ Sipas vëllimit janë fjalorë "xhepi", fjalorë bisedimorë, fjalorë "dore", fjalorë të vegjël, fjalorë të mesëm, fjalorë të mëdhenj dhe fjalorë "thesarë" ("thesaurus"). Natyrisht, tipi i një fjalori sipas vëllimit me të parën njihet nga numri i fjalëve (nga fjalësi a nga glosari) që përmban, por në thelb ky numër është rrjedhim i zbatimit të një parimi shkencor për hartimin e fjalorit: sa pasqyrohen shtresa aktive e shtresa pasive e leksikut në fjalor dhe sa i imët është zbërthimi i përmbajtjes së fjalëve në kuptime leksikore të veçanta; kështu, një fjalor i vogël përfshin thuajse vetëm shtresën aktive të leksikut të shqipe.

⁶ J. R. DEBOVE, *Typologie des dictionnaires généraux monolingues de la langue actuelle*, Quaderni del CIRSIL – 4 (2005) – www.lingue.unibo.it/cirsil, pp. 1.

skedat e fondit të A. Xhuvanit dalin si fjalë të rralla, të mbledhura në mbarë vendin, të mbledhura në veprat e autorëve të vjetër. Duket qartë se qëllimi i autorit nuk ka qenë të mbledhte fjalët e njohura, të leksikut themelor (sepse ato i gjejmë fjala vjen që te fjalori i K. Kristoforidhit) po qëllimi ka qenë mbledhja e fjalës së rrallë së shumti nga goja e popullit, që nuk kishte ardhur nga fjalorët e tjerë të botuar deri në atë kohë (sidomos nga fjalorët dygjuhësh). Vetëm në një përjasje që i bëmë shkronjës P (1740 fjalë) të këtij Fjalori me FGjSSH (1980), rezultoi se nga 1740 njësitë që ka kjo shkronjë, 457 njësi nuk gjenden fare në këtë fjalor, 157 janë variante.

Një çështje tjetër që meriton vëmendje të veçantë është edhe ajo e përcaktimit të llojit të lëndës leksikore të mbledhur nga prof. dr. Aleksandër Xhuvani ose e thënë ndryshe *Fjalori i gjuhës shqipe*, apo *Fjalë dhe shprehje të gjuhës shqipe*, do të shihen si një fjalor i gjuhës shqipe apo si një fjalor dialektor. Profesor A. Xhuvani ndërroi jetë në vitin 1961. Leksikografia shqipe në ato vite kishte arritur një sukses të merituar dhe të kërkuar për shumë dekada: ishte hartuar i pari fjalor shpjegues i gjuhës sonë, *Fjalori i gjuhës shqipe*, 1954 (me 25.000 fjalë), me autor Kostaq Cipo, Eqrem Çabej, Mahir Domi, Anton Krajni dhe Osman Myderizi. Vepra, para se të shkonte për botim, pas vdekjes së Kostaq Cipos, u ripa, d.m.th., u redaktua dhe u korrektua shkencërisht nga Eqrem Çabej, Mahir Domi dhe Anton Krajni, me të cilët bashkëpunoi Aleksandër Xhuvani, në atë kohë përgjegjës i Seksionit të gjuhësisë, të letërsisë e të folklorit në Institutin e Shkencave. Ky pranon se ka punuar veç tri javë në këtë fjalor dhe vetëm në periudhën e rishikimit, por e ka ndjekur “vazhderisht punën e hartueseve”.⁷ Fjalori i Aleksandër Xhuvanit është fjalor i fjalëve të rralla pasi hasen rrallë fjalët e përdorimit të përditshëm. Edhe kur janë dhënë, ato janë futur me qëllimin për të dhënë kuptimet e figurshme të tyre, frazeologjinë.

Puna për mbledhjen e fjalëve ka nisur që në kohën kur A. Xhuvani ishte drejtor i Normales së Elbasanit (1933-1938). Ai, para se nxënësit të niseshin për pushimet verore apo dimërore u jepte atyre detyra. Një ndër to ishte mbledhja e fjalës së rrallë. Këtë punë ai e ka vazhduar me dhjetëra vite me radhë, deri në fund të jetës së tij. P.sh. skeda: “kasmot (Gjirokastër): sot dy vjet, p.sh. vitin 1956.”

Përjasjet me Fjalorin e gjuhës shqipe (1954) janë bërë nga M. Domi e Q. Haxhihasani, kjo pasi A. Xhuvani e ka filluar shumë më herët, siç thamë edhe më lart. Por ka pasur raste kur ai i është referuar vetë FGjSh-së si p.sh.:

kri-a: krymb brees (Kanun??? 142), edhe Fjal. i Gj. Shq. 238) – pra edhe kjo skedë tregon që ai, edhe pas botimit të Fjalorit të Gjuhës Shqipe (1954) nuk e ndali punën për vjeljet dhe mbledhjet e fjalëve.

⁷ A. Xhuvani, *Çashtja e “Fjalorit të gjuhës shqipe”*, në A. Xhuvani, Vepra, 2, Tiranë, 1990, f. 106.

Studiuesi V. Memisha thekson se “A. Xhuvani, edhe në pozicionin e mbrojtjes së punës së tij si rishikues i veprës, shkruan se “ndër dy trajta fjalësh, që kanë një përhapje pak a shumë të gjerë ose të barabartë në gjuhën e së folmes e të shkrimit të dyja këto duhet të gjejnë vend në fjalor të gjuhës shqipe.”⁸. Sipas këtij studiuesi, këto trajta të gegërishtes nuk e shkelin bazën dialektore të *Fjalorit*, toskërishten. Kjo bazë dialektore duket faqeza e theksuar në gjithë strukturën e “Fjalorit” e në gjuhën e përdorur në të. Të shtënë brenda në Fjalor fjalë gegërishte, nuk i japin këtij ngjyrë krahinore, as nuk ia prishin bazën dialektore, toskërishten.”⁹ (Shpjegimi i fjalëve është dhënë në standard, pra jo siç është në skeda. Teksa studion gjuhën e përdorur nga Xhuvani për shpjegimin e fjalëve në skedë, duket qartë përpjekja e Xhuvanit për të shkuar drejt standardit, por ka shumë luhatje, çështje kjo që kërkon një studim më të thelluar).

Kur A. Xhuvani merrej me vjeljen dhe grumbullimin e pasurisë leksikore të shqipes, nga burime të folura të shkruara dhe të shkruara, diskutohej shumë për variantin e njëzuar të shqipes dhe, pavarësisht politikave gjuhësore të kohës dhe punës së bërë për hartimin e ortografisë / ortografive për variantin e njëzuar të mbështetur në toskërishte, akoma nuk kemi një shqipe të kodifikuar, nuk kemi vepra kodifikuese të miratuara (fonetikë normative, gramatikë normative, fjalor drejtshkrimor) as edhe fjalor shpjegues normativ. Prandaj përjasja e pasurisë leksikore që na la profesori si trashëgimi duhet të vendoset në kornizën kohore të viteve para se ai të largohej nga jeta.

Është fakt se shumë njësi të mbledhura prej tij kanë zënë vend në Fjalorin e gjuhës shqipe, 1954, që duket nga referimet që bëhen tek ky fjalor në botimet në faqet e Studimeve filologjike. Kurse autorët e Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe, 1980, e kanë shfrytëzuar plotësisht gjithë punën e prof. Xhuvanit. Verifikimi i plotë i saj, do të jetë një nga synimet e punës sonë në të ardhmen.

Nga gjithë sa parashtruam, themi se, meqenëse nuk kishim fjalor shpjegues normativ në kohën kur Xhuvani përgatiste fjalorin e vet apo “Kristoforidhin e vogël”, atëherë fjalori i tij nuk mund të quhet fjalor dialektor, edhe pse pasuria që ngërthen është grumbulluar në pjesën më të madhe në terren dhe u takon të folmeve qytetëse e fshatare të vendit.

E kundruar nga ditët e sotme, rreth 55 vjet pas vdekjes së prof. A. Xhuvanit, pas procesit kodifikues të shqipes dhe pas miratimit të variantit standard, që po funksionon prej mbi 40 vjet, pasuria e fjalorit vendoset në një kuadër shkencor asnjës. Shumë njësi janë përfshirë në leksikun normativ

⁸ A. Xhuvani, *Çashtja e “Fjalorit të gjuhës shqipe”*, në A. Xhuvani, Vepra, 2, Tiranë, 1990, f. 95.

⁹ *Shih më gjerë* A. Xhuvani, *Çashtja e “Fjalorit të gjuhës shqipe”*, në A. Xhuvani, Vepra, 2, Tiranë, 1990, f. 95.

ashtu si dhe shumë të tjera kanë mbetur në atë jo normativ. Në një fjalor të ri të tipit të madh kjo pasuri është një burim referimi për njësi të reja, për njësi sinonimike, për kuptime të reja a njësi të reja frazeologjike.

Në një punim të ardhshëm, duke u mbështetur në kritere të njohura në studimet tona gjuhësore, ne do të merremi më gjerësisht me klasifikime të lëndës në shtresën normative e atë jo normative, dialektore e krahinore.

Themi i mbarë shqipes, pasi gjeografia e mbledhjes është shumë e gjerë. Përfshin pothuajse të gjitha territoret shqipfolëse.

VENDE: Elbasan → 718, Lumë → 685, Gjirokastrë → 467, Tiranë → 411, Myzeqe → 328, Kosovë → 285, Shkodër → 246, Veri → 236, Dibër → 223, Vlorë → 203, Himarë → 194, Përmet → 193, Korçë → 174, Tomorricë → 131, Mirditë → 127, Jugë → 87, Kavajë → 63, Gramsh → 62, Labëri → 57, Tropojë → 53, Mallakastër → 52, Malësi e Shkodrës → 50, Çamëri → 49 Krujë → 49, Zagori → 45, Pogradec → 44, Kolonjë → 39, Librazhd → 37, Skrapar → 33, Peqin → 28, Dukagjin → 25, Pukë → 25, Peqin → 24, Shpat → 23, Kurvelesh → 21, Durrës → 20, Frashër → 19, Lushnjë → 18, Malësi e Veriut → 18, Shijak → 17, Krue → 16, Lushnjë → 16, Fier → 13, Malësi → 13, Gjakovë → 13, Malësi e Madhe → 11, Pejë → 10, Zadrimë → 9, Ersekë → 7, Sulovë → 7, Devoll → 6, Opar → 5, Polis → 5, Delvinë → 4, Has → 3, Leskovik → 3, Rrëshen → 3, Sarandë → 3, Shqipni e mesme → 2, Krumë → 1, Lumë, Radamir, Kalaja e Dodës → 1, Zabzun, Gollobordë → 1 arbër. e Greq. → 43, shqipt. e Ukrainës → 36, arbër. e It. → 32

arbër. e Siq. → 1, Hora e Arbëreshëve, Palermo → 1

AUTORE: P. Budi → 408, Kristoforidhi → 198, Buzuku → 171, Gazulli → 146

“Bashkimi” → 340, S. Kolea → 135, F. Noli → 68 Fan Noli → 58, Bogdani → 120, Dozon → 113, N. Frashëri → 87, A. Dani → 73, Argjirokastriti → 67, De Rada → 63, Leotti → 48, S. Frashëri → 37, Negovani → 35, Q. Haxhihasani → 33, Mitko → 24, Fjalorth i ri → 20,

Anonim → 19, Pedersen → 19, Hahn → 14, Anonim i Elbasanit → 7, M. Çami. Erv. → 5

A. Xhuvani mbledhi fjalë gjithandej Shqipërisë. Shpesh regjistroi me vetëdije, se dialektet e shqipes janë shumë afër njëri - tjetrit dhe pasuria leksikore e secilit është pasuri e gjithë gjuhës amtare. Fjalori i Aleksandër Xhuvanit është një fjalor dialektor, por është i mbarë shqipes, pasi aty i gjejmë të dy dialektet. Pra shpërndarja gjeografike është shumë e gjerë. E veçanta e tij është se shumë herë gjejmë të pranëvendosura të dy variantet leksikore të një fjale geqe/toske.

bëj / baaj, bëhem / bâhem, ftoh / ftof, gjindem / gjendem, lë / lâ, ndej / ndëj / ndenj / ndeh, përflas / përflasij / përfol, shoh / shof, them / thom, vë / vë, zâ / zë

Duhet theksuar fakti se lënda që u botua, u përzgjedh nga M. Domi e Q. Haxhihasani dhe qenë ata që e bënë zgjedhjen e kësaj paraqitjeje. Duke parë fondin e A. Xhuvanit, ku gjejmë të tilla pranëvendosje edhe brenda një skede, na bën të mendojmë që të dy këta profesorë kanë respektuar vullnetin e tij.

Sipas *trajtimit leksikografik* janë fjalorë shpjegues, dygjuhësh a shumëgjuhësh, alfabetikë a çerdhorë, ideografikë, të anasjellë (inversë), fjalorë elektronikë a konkordancash etj.

Fjalori i A. Xhuvanit është edhe një fjalor shpjegues, por e veçanta e këtij fjalori është se aty gjejmë shumë përshtatje me gjuhët e tjera

Është Fjalor *sui generis*, pasi edhe pse është fjalor njëgjuhësh aty gjen larmi përqasjesh me gjuhë të tjera si, p.sh.: italishten (940 përqasje), frëngjishten (890), greqishten (640), gjermanishten (350), rumanishten (76), latinishten (66), turqishten (14), sllavishten (11), serbishten (10).

Si përfundim Fjalori i Aleksandër Xhuvanit në një botim të plotë do të ketë formatin e një fjalori të vogël në numër njësisht, por që shkon nga lënda semantike e frazeologjike drejt një fjalori të mesëm, do të përfshihet në fjalorët dialektorë, ose më saktë do të jetë një fjalor mbarëdialektor i shqipes, pasi aty i gjejmë të pasuri nga të dy dialektet dhe të gjitha të folmet.